

LIGJ
Nr.10 117, datë 23.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 113 pika 1 shkronja “ç”, 155 dhe 157 pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 11 “Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël” pika 5, fjalët “në kufijtë plus/minus 30 për qind” zëvendësohen me fjalët “në kufijtë plus 10/minus 30 për qind”.

Neni 2

Në nenin 21 “Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme”, fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ndërsa për tatimpaguesit e biznesit të vogël kufijtë janë plus 10/minus 30 për qind.”.

Neni 3

Në nenin 32 “Taksa të tjera” bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“b) bazën dhe nivelin për taksën e tabelës, e cila, së bashku me taksat dhe tarifatat e aplikueshme, nuk duhet të jetë më shumë se 10 për qind e nivelit tregues të taksës së biznesit të vogël, sipas kategorisë së rrethit dhe qarkullimit vjetor.”.

2. Në shkronjën “ç” të pikës 2, fjalët “në kufijtë +/- 30 për qind” zëvendësohen me fjalët “në kufijtë plus 10/minus 30 për qind”.

Neni 4

Neni 33 “Taksat e përkohshme vendore” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

Këshilli bashkiak ose komunal, kur e gjykon të domosdoshme, vendos taksa me karakter të përkohshëm, në interes të përgjithshëm të komunitetit, në territorin brenda juridiksionit të tij. Masa e taksave me karakter të përkohshëm, së bashku me taksat dhe tarifatat e aplikueshme, nuk duhet të kalojnë kufirin plus 10 për qind të nivelit tregues të taksës së biznesit të vogël, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të këtij biznesi.”.

Neni 5

Në nenin 35 “Tarifat vendore dhe administrimi i tyre”, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifat do të mblidhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent, por në asnjë rast shuma e tarifave vendore, të aplikueshme për tatimpaguesit e biznesit të vogël, nuk duhet të kalojë 10 për qind të nivelit tregues të taksës, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të biznesit të vogël.

Në rastin e agjentit, këshilli vendos rregullat bazë kufizuese në raport me agjentin, ndërsa kryetari i bashkisë ose i komunës bën përzgjedhjen e agjentit, si dhe lidh kontratë me të.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6158, datë 7.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**